

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me objekt: “**Blerje licensa dhe suport vjetor**”.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,166,667 lekë (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Agrokredit sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës duhet te kete

te punesuar nje personel teknik mesatarisht **2(dy)** punonjës, të siguruar për 3 mujorin e fundit nga data e hapjes se ofertave me keto kompetenca:

1. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne menaxhimin e sherbimeve IT, ITIL ose ekuivalent
2. Të paktën 1 (nje) specialiste të certifikuar nga prodhuesi për siguri në rrjetat kompjuterike
3. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per sigurine kibernetike, nga prodhuesi **ose ekuivalent**
4. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per virtualizim te dhenash nga prodhuesi **ose ekuivalent**
5. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per mbrojtje email dhe komunikime **ose ekuivalent**

Një punonjës mund të ketë më shumë se një kompetencë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin para dhënjes së kontratës:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST,
- Dëshmitë / Certifikata për specialistët e kërkuar origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin
- CV-te dhe diplomat nga universitet perkates.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për tre muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.

Per tu permbushur keto kriteret operatoret ekonomik duhet te bazohen nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*

1.Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne menaxhimin e sherbimeve IT, ITIL ose ekuivalent.

Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Para dhënies së kontratës, për vërtetimin e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të paraqesin Certifikatat perkatese, CV-te dhe diplomat nga universitet perkates. Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata. *Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, certifikata e menaxhimit të shërbimeve IT, ITIL ose ekuivalent është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon pervojen e personelit për shërbimet që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi ka aftësi të udhëheqje dhe të raportojë menaxhimin e sistemeve të informacionit në funksion të përzgjedhjes planifikimit, shpërndarjes dhe mirëmbajtjes së ciklit të përgjithshëm të jetës së shërbimeve të IT, si dhe të garantojë që procesi është konform standardeve të menaxhimit të sistemeve të informacionit dhe nuk është një premisë thjesht për një aktivitet suporti në back end, por një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit të suportit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të Autoritetit Kontraktor.

Objekti i prokurimit të kësaj procedure ka të bëjë me sistemin e licencave që përfshin njerez, procese dhe sisteme të teknologjisë së informacionit. Certifikimi për menaxhimin e sistemeve të informacionit përcakton nivelin profesional të një punonjësi që garanton në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e sistemit të menaxhimit në teresinë e vet tek aktivitetet e operatorit ekonomik. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë pervojen profesionale për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin para dhenies së kontratës Certifikatat perkatese, CV dhe diplomat nga universitet perkates me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të aftësinë profesionale për të zbatuar kontratën.

2. Të paktën 1 (një) specialiste të certifikuar nga prodhuesi për siguri në rrjetat kompjuterike .

Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Para dhënies së kontratës, për vertetimin e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të paraqesin Certifikatat perkatese, CV-te dhe diplomat nga universitet perkates. Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata. *Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, certifikimi nga prodhuesi për siguri në rrjetat kompjuterike në nivelin Arkitekt Sigurie është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon përvorjen e personelit për produktet e shërbimet që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi ka aftësi të implementojë, konfigurojë dhe administrojë produktet e sistemit të mbrojtjes së trafikut email dhe për të përmirësuar arkitektura të sistemeve të informacionit. Punonjësi i certifikuar për rrjetat kanë njohuri të thelluara për identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë, duke siguruar mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga potenciale rreziqe të tilla.

Objekti i prokurimit të kësaj procedure ka të bëjë me furnizimin e një sistemi mbrojtje që përfshin një teresi procesesh dhe sistemesh të teknologjive të informacionit. Thëksojmë se protokollet e komunikimit janë të njohura si nga burimet/shkaqet kryesore të ekspozimit të vulnerabiliteteve të rrjetit dhe aplikacioneve ndaj sulmeve kibernetike keqberëse të qëllimshme apo të rastësishme. Certifikimi i 1 (një) punonjësi të operatorit ekonomik, për administrimin e pajisjeve të sigurisë përcakton nivelin profesional të një punonjësi që garanton në mënyrë të vazhdueshme procesin e modulimit, instalimit dhe konfigurimit. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmblidhjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë përvorjen profesionale për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës. Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin para dhënies së kontratës Certifikatat perkatese, CV dhe diplomat nga universitet perkates me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të aftësi profesionale për të zbatuar kontratën.

3. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë kibernetike, nga prodhuesi ose ekuivalent

Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Para dhënies së kontratës, për vertetimin e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të paraqesin Certifikatat perkatese, CV-te dhe diplomat nga universitet perkates. Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata. *Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, certifikimi për sigurinë kibernetike është një mënyrë për të

vërtetuar se operatori ekonomik ka njohuri dhe aftësi të përshtatshme për të menaxhuar situata emergjente dhe të mbrojtë të dhënat nga rreziqet potenciale dhe njohuri të thelluara për identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë. Certifikimi për sigurinë kibernetike siguron njohuri të thella rreth rreziqeve potenciale të sigurisë, duke përfshirë rreziqet nga sulmet kibernetike, dhe ofron strategji për të parandaluar, zbuluar, dhe trajtuar këto situata emergjente.

Personat e certifikuar kanë njohuri për të zhvilluar dhe zbatuar plane të mbarëvajtjes emergjente. Kjo përfshin rikthimin e shërbimeve të rëndësishme pas një ngjarje madhore. Një certifikim në këtë fushë përfshin njohuritë për të vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet, duke identifikuar zonat e dobëta dhe duke zbatuar masat e nevojshme për të zvogëluar ndikimin e mundshëm të një incidenti..

Certifikimi i i 1 (nje) punonjesi te operatorit ekonomik, për sigurinë kibernetike të një punonjesi që garanton në mënyrë të vazhdueshme procesin identifikimit dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë, duke siguruar mbrojtjen e infrastruktures kritike nga potenciale rreziqe apo sulme kibernetike. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë përvojën profesionale për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës. Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin para dhënies së kontratës Certifikatat perkatese, CV dhe diplomat nga universitet perkates me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të aftësi profesionale për të zbatuar kontratën.

4. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar për virtualizim të dhenash nga prodhuesi ose ekuivalent

Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST. Para dhënies së kontratës, për vërtetimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatat perkatese, CV-te dhe diplomat nga universitet perkates. Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikata. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin

Argumentimi: *Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, certifikata e punonjesit për virtualizim të dhenash nga prodhuesi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon përvojën e personelit për shërbimet që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi ka aftësi për të ofruar suportin e nevojshëm në procesin virtualizimit të të dhënave në funksion të sistemeve informatike që menaxhohen nga AK, si dhe të garantojë që procesi është konform standardeve të menaxhimit për kryerjen e backup dhe replikimit. Objekti i prokurimit të kësaj procedure ka të bëjë me sistemin e licencave që përfshin njerez, procese dhe sisteme të teknologjisë së informacionit. Certifikimi për virtualizim të dhenash përcakton nivelin profesional të një punonjesi që garanton në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave të AK. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.*

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë përvojën profesionale për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës. Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin para dhenies së kontratës Certifikatat perkatese, CV dhe diplomat nga universitet perkates me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të aftësinë profesionale për të zbatuar kontratën.

5. Të paktën 1 (nje) punonjes te certifikuar per mbrojtje email dhe komunikime ose ekuivalent

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat i japin të drejtë Autoritetit Kontraktor të kërkojë kapacitete teknike dhe profesionale të pershtatshme, në përputhje me objektin dhe kompleksitetin e kontratës.

Objekti i prokurimit lidhet drejtperdrejte me furnizimin, implementimin dhe administrimin e zgjidhjeve të sigurisë së informacionit, ku mbrojtja e email-it dhe komunikimeve elektronike përben një nga vektorët kryesorë të rrezikut kibernetik, përfshirë phishing, malware, ransomware, komprometimin të llogarive dhe rrjedhjet e të dhënave sensitive.

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për mbrojtjen e email-it dhe komunikimeve elektronike është e domosdoshme për të garantuar që operatori ekonomik disponon ekspertizën profesionale për konfigurim, administrim, monitorim dhe përditësimin e vazhdueshëm të sistemeve të sigurisë komunikimeve në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare të sigurisë së informacionit.

Ky kriter nuk është diskriminues pasi :

Nuk kufizohet në një prodhues të vetëm

Pranon certifikime ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht

Lejon që një punonjes të mbulojë më shumë se një kompetencë duke garantuar proporcionalitetin e kërkesës

Lidhet drejtperdrejt me objektin e kontratës dhe me nevojën reale të Autoritetit Kontraktor për mbrojtjen e infrastrukurës së komunikimit elektronik

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet 2023, 2024, dhe 2025 ku vlera e xhiros minimale në të paktën një vit, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 55/4 paragrafi i dytë i VKM 285 datë 19.05.2021, i cili parashikon se kapacitetet ekonomike për procedurën e hapur të thjeshtuar plotësohen edhe vetëm me paraqitjen e deklaratës së xhiros vjetore.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 2, gërma c) pasi fondi limit i procedurës së prokurimit është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm në përmjet formës elektronike "Udhëzimi të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Gjithashtu neni 43 pika 1 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcakton edhe periudhën e viteve (maksimumi deri 3 vitet e fundit financiare) për të cilat mund të kërkohej dorëzimi i deklaratave të xhiros vjetore.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të viteve 2023, 2024, dhe 2025, ku te paktën **në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit**. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese*.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më e vogël 20% se vlerës së përlogaritur të fondit limit** .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,

afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë **jo më e vogël se 20% e fondit limit**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (vlerë jo më e madhe se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës).*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve:

I - ISO 9001 ose **sipas standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit** ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme ditën e hapjes së ofertave).

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e mësipërme (Nëse nuk është në gjuhën shqipe, çertifikata duhet të përkthehet e të noterizohet).

II - ISO/IEC 20000-1 ose **sipas standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit** ose ekuivalente (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit) (e vlefshme ditën e hapjes së ofertave).

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e mësipërme (Nëse nuk është në gjuhën shqipe, çertifikata duhet të përkthehet e të noterizohet).

III - ISO 27001 ose **sipas standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit** ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme ditën e hapjes së ofertave).

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e mësipërme (Nëse nuk është në gjuhën shqipe, çertifikata duhet të përkthehet e të noterizohet).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, I ndryshuar secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar)

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën e mirembajtjes.

Përmbushja e standartit **ISO 9001** ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Certifikimi **ISO 20000-1** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në tërësi i cili është tërësisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky lloj certifikimi garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës janë sipas standarteve për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

Certifikimi **ISO 27001** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rendësi dhe konfidencialitet të lartë të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshem e i kodifikuar. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet e duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të shërbimeve të suportit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë partneritet me distributorë/rishitës të autorizuar ose të certifikuar zyrtarisht nga një ose më shumë prodhues të sistemeve të mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit dhe aplikacioneve, si dhe nga prodhues të platformes së virtualizimit pa kërkuar ekskluzivitet. Kjo, për të garantuar cilësinë e shërbimeve perkatese që do të kryhen mbi këto sisteme. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqiten certifikatat ekuivalente ose deklarimi në faqen zyrtare të prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Gjithashtu, partneriteti është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/liçensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i aftë të regjistrojë dhe të ofrojë suportin vjetor (licensat) tek AK. Ky dokument lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e për të cilat ofrohet licensimi sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë marrëdhënien e nevojshme për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qenë se objekt i kësaj procedure prokurimi janë licensa dhe suport vjetor është vlerësuar e nevojshme të kërkohet partneriteti për licensat e kerkuara, pasi të gjitha licensat regjistrohen/aktivizohen në regjistrat e prodhuesve vetëm nepermjet kanaleve të autorizuar sic janë partneret e prodhuesit. Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin certifikatën e partneriteti apo një deklaram në faqet zyrtare të prodhuesve me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomikë kanë të drejta partneriteti, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e licensimit apo suportit vjetor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar, nga komisioni i posaçëm i cili është ngritur me Urdhrin perkates të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevojat e AK